



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 07

Datë: 21. 03. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr.06/2023

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e Zyrës ZRCKFSP

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Njoftim për Specifikat për distinktiv ID-Bexha,

- Njoftim me Formularët për aplikimit për votim jashtë Kosovës
 - **Këshilli për Buxhet dhe Financa**
- Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2024-2026
- **Këshilli për Personel**
- Njoftim për zbatimin e planit të rekrutimit 2023

5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i IP

6. Njoftim nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm

7. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e mbledhjes, dhe pyeti se a ka dikush ndonjë propozim, vërejtje ?

Rifat Krasniqi, kërkoi shpjegim lidhur me konkursin për KKZ më komunën e Mamushës...! Kryetari Radoniqi tha se, kjo do të diskutohet në këshillin e peronelir...

Ndërsa, nuk pati tjetër propozim, me 8 vota për dhe një abstenim (Gordna Llaban), u miratua procesverbali nr. 06/2023.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, kryeshe i SKQZ, paraqiti një raport të gjatë të aktiviteteve mes dy takimeve. Ai tha se, më 16 mars 2023, janë publikuar në ueb faqen e KQZ-së ëëë.kqz-ks.org (Legjislacioni > Rregullat Zgjedhore) apo në vegzën direkte: <https://kqz-ks.org/rregullat-zgjedhore/> 15 Rregulloret e reja për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, të cilat u miratuan më 9 mars 2023. Në vazhdim, ai i prezantoi të gjitha rregullat të cilat, tashmë janë përfunduar.

Në vazhdim, ai tha se në ueb faqen e KQZ-së është dhënë një sqarim lidhur me atë se organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të katër komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet komunale të dy komunave: Zveçan dhe

Leposaviq, të cilat do të mbahen më 23 prill 2023, organizohen sipas Rregullave Zgjedhore të mëhershme të miratuara nga KQZ-ja.

Kryeshefi Ahmetaj, tha pastaj se sipas nenin 19 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Instruksionit të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sikurse edhe organizatat e tjera buxhetore, është i obliguar që të përgatis, aprovoj dhe dorëzoj në Qeveri deri me 21 mars Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026 që mbulon tre vitet e ardhshme fiskale 2024-2026. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026. Si prioritet i KQZ-së, në tri vitet e ardhshme do të jetë:

1. Përmbushja e objektivave të planifikuara në Planin Strategjik. 2. Dgjitalizimi i procesit zgjedhor. 3. Identifikimi elektronik i votuesve. 4. Rritja e pjesëmarrjes së votuesve dhe posaçërisht e femrave në zgjedhje. Informimi dhe edukimi i votuesve të rinj për zgjedhje. 5. Ggatishmëria për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve kurdo që kërkohet.

Ahmetaj, vuri në dukje se në KASH 2024-2026, nuk janë të përfshira aktivitetet të cilat pritet të dalin nga Ligji sepse reforma zgjedhore është në proces e sipër. Mirëpo, pas miratimit të ligjit në dokumentet e tjera do të përfshihen të gjitha aktivitetet duke i përfshirë edhe koston buxhetore të tyre. Po ashtu ndër objektivat strategjike të KQZ-së do të jetë edhe trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimi i komunikimit me partitë politike dhe akterët tjerë relevant.

Gjithashtu, u raportua se Sekretariati është duke i finalizuar përcaktimin e indikatorëve të Planit Strategjik 2023-2026 dhe finalizimi pritet të bëhet në fund të javës. Pastaj, KQZ u informua mbi atë se rapori vjetor i punës së KQZ-së, për vitin 2022, është në fazën finale të draftimit dhe në fund të muajit mars ose fillimit të muajit prillit 2023, do të prezantohet për shqyrtim në Këshillin për Operacione Zgjedhore dhe për miratim në KQZ. Raportit do t'i bashkangjiten edhe aneksi i raporti vjetor financiar i KQZ, për vitin 2022. Raporti, planifikohet të dërgohet në Kuvend e Republikës së Kosovës në afatin ligjor në fund të muajit prill 2023.

Në vazhdim, z. Ahmetaj raportoi për përgatitjet sipas planit operacional për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023. Për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, e cila ka filluar me 20 mars dhe përfundon me 27 mars 2023, njoftimi është shpërndarë për transmetim dhe publikim në mjetet e komunikimit si në vijim: RTK1,

RTK2, RTK3, RTK4, Radio Kosova1, Radio Kosova2 dhe në portalin e RTK-së. Po ashtu njoftimi ju është dërguar edhe organizatave të shoqërisë civile dhe zyrtarëve ndërlidhës të komunave, për publikim në ueb faqe dhe në rrjetet e tyre sociale.

Sekretariati i KQZ-së, është në fazën e zhvillimit të procedurave për furnizime dhe shërbime për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023. Aktualisht, tha Ahmetaj, një pjesë e aktiviteteve të prokurimit kanë kaluar fazën e vlerësimit dhe janë para nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër janë në procesin e vlerësimit teknik të ofertave.

Në fund, u tha se Sekretariati i KQZ-së më datën 10 mars 2023, i ka dërguar ftesat subjekteve politike për nominimin e rikonfirmimeve për anëtar të KKZ-ve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq 23 prill 2023. Subjektet politike konform nenit 67 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe nenit 3,4 dhe 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.18/2016, deri më datën 17.03.2023, kanë qenë të obliguara të dorëzojnë nominimet për anëtar të KKZ-ve në KQZ. Pas pranimit të nominimeve Sekretariati i KQZ-së është duke bërë verifikimet e nevojshme të nominimeve të pranuar deri më tani dhe në mbledhjen e radhës të KQZ-së, do t'i prezantoj për shqyrtim dhe miratim në KQZ.

Në vazhdim të mbledhjes, kryetari Radoniqi i pyeti anëtarët e KQZ –së rreth raportit, se çfarë kanë ata lidhur me këtë raport, a kanë ndonjë pyetje, plotësim etj.

Nuk pati diskutime...

3. Aktivitetet e Zyrës ZRCKFSP

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP lidhur me afatin e konfirmimit për certifikim të kandidatëve që kanë qenë në afatin e dhjetorit. Ky afat, ishte prej datës 9-13 mars. Subjektet, kanë konfirmuar kandidatët e njejtë si për kandidatë komunash, dhe për asambleistë. Kandidatët, janë në rregull nga aspekti ligjorë – procedural.

Arianit Elshani, pyeti se a ka ndonjë subjekt tjetër, por dorëzim të dokumentacionit nuk ka, vec interesimit të AAK-së për të marrë pjesë në zgjedhje.

Ilir Gashi: Tha se, ju po thoni që ka vetëm konfirmime. A ka ndonjë kandidatë që ka dhënë dorëhqeje, mirëpo tani nuk ka apliku...

Buzhala, tha se, ka subjekte që kanë thënë se do të aplikojnë dhe, ne jemi në agjendë të kësaj çështjeje...

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Njoftim për Specifikat për distinktiv ID-Bexha:

Arianit Elshani, tha se këshilli ka shqyrtuar një kërkesë që ka dalë nga mbledhja e kaluar e KQZ për shtypjen e ID-bexhave (dinjektivëve), dhe se këshilli ka rekomanduar që të vazhdohet me specifikat e kaluara, me disa kritere të lehtësuara...Për të ardhmen, do të kemi shqyrtime dhe përgatitje të tjera lidhur me bexhat...

Ndërsa, sa u përket formularëve për aplikimit për votim jashtë Kosovës, tha z. Elshani, këtu është një ndryshim teknik dhe se, nuk ka ndryshim me përmbajtjen dhe kriteret nga zgjedhjet e kaluara...

Në këtë pikë, diskutuan dhe shtruan pyetje z. Sami Kurteshi lidhur me “teknologjinë” e prodhimit të bexhave, ndërsa z. Elshani bëri shpjegimet e nevojshme në këtë drejtim.

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2024-2026:

Ilir Gashti, tha se në mbledhjen e kaluar të KBF, ku kemi bërë shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2024-2026, dhe kemi miratuar si në vijim çështjet: buxheti i vitit 2024, do të jetë në vlerë prej **7.303 807** euro. Për vitin 2025, buxheti do jetë prej **22 490 304** euro. Pwrndryshe, hpenzime operacionale janë dy palë zgjedhje në pyetje: lokale dhe qendrore, si dhe janë planifikue aktivitete për vitin 2026.

Ne rekomandojmë për miratim...

Diskutuan, analizuan dhe shtruan pyetje: Arianit Elshani, Miradije Mavriqi, DAP, Sami Kurteshi, Besnik Buzhala, Alban Krasniqi, Čemailj Kurtiš, Burim Ahmetaj, dhe Kreshnik Radoniqi.

Në fund, me ndryshime e propozuara rreth Zyrës, anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, e miratuan kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën: 2024-2026.

Këshilli për Personel

Njoftim për zbatimin e planit të rekrutimit 2023:

Alban Krasniqi, tha se e kemi mbajte një mbledhje por se kemi përfunduar, besoj që do ta vazhdojmë nesër...Ideja ishte të diskutojmë për planin e rekrutimit, procedurat e ndjekjes etj. Unë, kam kërkuar më shumë njoftime, sepse nuk kam qenë kur është bërë ky plan, dhe besoj që do të vazhdojmë më tutje...

Krasniqi, tha se, duhen më shumë shqyrtime, analiza dhe mënjanim të probleme që, tha se janë të dukshme, si për shembull çështjet e ndjekjes së procedurave të njëjta, kriteret etj. Ka një lloj laramanie, tha Krasniqi, kurse mungon informacioni në ueb faqe rreth rrjedhës së konkurseve...

Ai, foli konkretisht lidhur me mos shpalljen e konkursit të “koordinatorit” të QNR-së dhe, tha se referenca e dhënë është e gabuar, vendi është i lirë...

Për katër komunat e shpallura, z. Krasniqi për një parantezë: “ka komuna që konkurset janë shpallur më herët dhe nuk janë përfunduar, ndërsa ka komuna që konkurset janë shpallur më vonë dhe tash janë përfunduar...!” Nuk është se respektohen kriteret, dhe se diku zbatohen kriteret, e diku jo, tha Krasniqi.

Nesër, do të kemi takim, dhe do të vijmë me rekomandime në mbledhjen e KQZ...

Rifat Krasniq, tha se në Mamushë ka probleme. Zyrtari i pranuar si kryesues i KKZ në Mamushë nuk është nga kjo komunë, nuk është në listë votuese...S’i është pranue se di, është shkelje ligjore...!

Nuk e di, ky është gabim...?

Ilir Gashi tha se, këshillat kanë kufizimet e veta, ndërsa për çështjet e rekrutimit unë nuk jam për të diskutuar, kjo është çështje e Sekretariatit, e kryeshefit...Pra, sa më përket mua për këto çështjeve, unë s’mendoj që duhet të përzihem si anëtarë i KQZ, aq sa kemi kompetencë...

Janë instancat e tjera ku duhet të ankohemi, tha z. Gashi dhe pasojat, i bartin ata që bëjnë shkelje ligjore. Ne, komunikojmë me sekretariatit përmes kryeshefit... Është ligji, dhe ne s’mund të marrim kompetenca përtej ligjit...

Kreshnik Radoniqi, tha se Sekretariati e ka pavarësinë e tij, unë tash se di saktësisht çka, por nëse shihen shkelje të vazhdueshme në procedurat e rekrutimit duhet të ndërhyjë edhe KQZ. Kjo, për tu respektu procedurat e drejta... Jam për zbatim të procedurave të njëjta...

Sami Kurteshi, nuk u pajtua me diskutimin e Ilir Gashi dhe tha se, dhe se, “unë si anëtar i KQZ-së kam për obligim me vepru kur çështjet nuk janë në rregull, dhe kur ka raste si në Mamushë duhet të interesohemi ne...! Unë, nuk pajtohem. Ka pavarësi funksionale, por jo absolute. Nëse i them gjërat me emër e mbiemër, nëse e kërkon një dokument në Sekretariat etj., duhet ti kemi, duhet të jemi transparent...”

Arianit Elshani, foli gjatë rreth këtyre çështjeve, procedurave, çështjeve të rekrutimit dhe tha se për çdo pozicion, kudo që ka shkelje duhet ti kemi dëshmitë, faktet dhe nuk duhet të lëshohemi në komente... Janë procedurat, është këshilli i personelit, ankesat, afatet për to dhe si për KQZ dhe për çdo qytetarë, duhet të jemi transparent. Dhe Këto diskutime, së pari duhet të bëhen në këshill të personelit, dhe s’mendoj që duhet ti komentojmë e trajtojmë pa ndonjë dokument...

Diskutuan edhe: Čemailj Kurtiš, Rifat Krasniqi, Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi, i cili kërkoi që këshilli ti diskutoj edhe njëherë të gjitha problematikat dhe ti sjellë në mbledhjen e KQZ...

Anëtarët e KQZ-së, u pajtuan me këtë propozim.

5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i IP

Fazli Stollaj, tha se Këshilli Mbikëqyrës i IP i ka mbajtur dy takime lidhur me procesin zgjedhor në 4 komuna. Ka miratuar 5 njoftime të planit operacional, dhe tekstet janë miratuar në dy formate: për mediat vizive, dhe tjetra, për rrjetet sociale dhe në ueb faqen tonë...

6. Njoftim nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Sami Kurteshi, kryesues i KO-së tha se kemi mbajtur mbledhjen e parë të këtij viti, ku e kemi trajtue një raport të auditimit të brendshëm lidhur me shpenzimet e brendshme të KQZ. Ai tha se, e gjetura është se buxheti për “shpenzime dhe mallra” është i njëjtë, nga viti në vit dhe se, nuk e kalon shpenzimin më shumë se 60%, madje kur ka zgjedhje, ndërsa kur ka zgjedhje nuk i kalon shpenzimet as 35%...

Në këtë pikë, diskutuan: Ibrahim Selmanaj, Arianit Elshani, Alban Krasniqi. Në diskutimet e tyre, nga “kjo e gjetur” ata thanë se, duhet të shihen çështjet dhe të tregohet më shumë fleksibilitet lidhur me shpenzimin e buxhetit...

7. Të ndryshme !